

26



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR VLORE

Nr. Regj Them 239

Datë 25.04.2013

Nr vendimi 239

Data 02.05.2013

V E N D I M

"NE EMER TE REPUBLIKES"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë e përbërë prej:

VJOLA CANAJ GJYQTARE

Asistuar nga sekretare gjyqësore Entela Omeri, sot më datë 02.05.2013 mari në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën që i përket:

**Kërkues:** Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, përfaqësuar me autorizim nga prokurorë  
[Redacted]

**Objekti:** Konfiskim mjete lundrues

**Baza ligjore:** Neni 23/3 dhe 24/3 i ligjit nr 8663 datë 18.09.2000 "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruesa me motor me tonazh nën 20 nt, si dhe neni 36 i Kodit Penal.

Gjykata, pasi u njoh me kërkesën objekt gjykimi dhe aktet që e shoqëronin atë,

V E R E N

Se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka paraqitur përpara kësaj gjykate kërkesën me objekt "Konfiskim mjete lundrues të llojit gomone, me ngjyrë të bardhë, me mbishkrimin "EDDI" në të dyja krahet dhe mbishkrimin "MARES" në kabinën e pilotimit, si dhe një gjatësi 6 metër dhe gjerësi 2,2

metër, me dy motora të markës "Suzuki 150 hp" dhe "Parsun 9,9 hp" dhe kalimin e tij në favor të shtetit."

Nga gjykimi rezultoi e provuar se më datë 24.04.2013, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka regjistruar procedimin penal nr 476 të vitit 2013 për veprat penale "Mosdeklarimi i zotërimit ose mbajtjes së mjetit lundrues" dhe "Mungesa e matricullimit ose mbajtjes së mjetit lundrues" parashikuar përkatësisht nga nenet 23/1 e 24/1 të ligjit nr 8663 datë 18.09.2000 "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor me tonazh nën 20 nt".

Nga aktet e paraqitura në mbështetje të kërkesës objekt gjykimi ka rezultuar e provuar se më datë 21.04.2013, rreth orës 01.00, në vendin e quajtur "Plazhi i Vjetër" të qytetit të Vlorës është konstatuar nga policia kufitare një mjet lundrues me dy persona në bord dhe ky mjet ka qenë në lëvizje për nga porti i qytetit të Vlorës.

Nga ana e punonjësve të policisë së grupit të gatshëm u është bërë thirrje personave në bord të këtij mjeti lundrues, por ata janë larguar me shpejtësi duke iu afruar bregut dhe më pas kanë braktisur mjetin.

Ky mjet është bllokuar nga policia dhe nga kqyrja e tij ka rezultuar se kishte një gjatësi 6 metër dhe gjerësi 2,2 metër, me dy motora të markës "Suzuki 150 hp" dhe "Parsun 9,9 hp", të cilët në momentin e bllokimit kanë qenë të ndezur.

Ka qenë kjo baza mbi të cilën nga ana e policisë gjyqësore pranë Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit Vlorë i janë dërguar materialet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe kjo e fundit ka regjistruar procedimin penal për veprat penale "Mosdeklarimi i zotërimit ose mbajtjes së mjetit lundrues" dhe "Mungesa e matricullimit ose mbajtjes së mjetit lundrues" parashikuar përkatësisht nga nenet 23/1 e 24/1 të ligjit nr 8663 datë 18.09.2000 "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor me tonazh nën 20 nt".

Neni 12 i ligjit të mësipërm parashikon:

"Cilido që zotëron ose mban, me çfarëdo lloji titulli, një mjet lundrues ose pjesë të tij, duhet të bëjë deklarinimin me shkrim, brenda njëzet e katër orëve nga marrja në zotërim ose në mbajtje, në zyrën e policisë kufitare, përgjegjëse për territorin, duke shënuar gjeneralitetet dhe vendqëndrimin e tij, vendbazimin e përhershëm të mjetit, si dhe gjeneralitetet e pronarit ose të bashkëpronarëve. 2. Zotëruesi ose mbajtësi duhet të mbajnë gjithmonë me vete dokumentet që dëshmojnë matricullimin dhe regjistrimin e mjetit lundrues. 3. Deklarimi i zotërimit ose i mbajtjes duhet të bëhet sa herë ndryshon vendbazimi i përhershëm i mjetit."

Neni 23 i po atij ligji parashikon:

"1. Mosdeklarimi i zotërimit ose i mbajtjes, siç parashikohet në nenin 12, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 100.000 (njëqind mijë) deri në 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, si dhe me konfiskimin e mjetit lundrues. 2. Oficeri ose agjenti i policisë kufitare, që ka verifikuar shkeljen,

27

sekuestron mjetin lundrues dhe respekton procedurën e parashikuar në pikat 3, 4, 5 e 6 të nenit 31. 3. Gjykata, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e masës së sekuestrimit, vendos për konfiskimin e mjetit lundrues."

Në rastin objekt gjykimi, gjykata cmon se ndodhemi përpara kushteve të parashikuara nga neni 23 i sipërcituar, pra ndodhemi përpara një shkeljeje të konstatuar nga oficeri i policisë gjyqësore më datë 21.04.2013. Konkretisht, nuk është deklaruar zotërimi apo mbajtja e një mjeti lundrues dhe nuk është matrikulluar apo regjistruar ky mjet lundrues.

Sanksioni i vendosur në këtë rast ka qenë sekuestrimi i këtij mjeti.

Një tjetër kërkesë e kësaj dispozite është edhe respektimi i procedurës së parashikuar nga pikat 3, 4, 5 e 6 të nenit 31 të po këtij ligji, i cili parashikon veprimet e policisë gjyqësore. Sipas këtij neni:

"1. Oficeri i policisë gjyqësore i zyrës së policisë kufitare, përgjegjës për territorin, me vendim të gjykatës kontrollon në vendet ku ka të dhëna të bazuara se fshihen ose mbahen në mënyrë të paligjshme mjete lundruese, objekt i këtij ligji, në kundërshtim me nenet 11, 12, 17 e 18 të këtij ligji. 2. Oficeri i policisë gjyqësore mund të veprjë me nismën e vet në rastet e flagrancës, sipas kriterëve të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale. 3. Në çdo rast, oficeri i policisë gjyqësore harton në tri kopje procesverbalin e kontrollit dhe të sekuestrimit të mundshëm të mjetit lundrues si element prove i veprës penale, ia dorëzon një kopje të procesverbalit të interesuarit nëse është i pranishëm, një kopje ia dërgon prokurorit përgjegjës dhe kopjen e tretë e arkivon në aktet e zyrës. 4. Në procesverbalin e parashikuar në pikën 3 duhet të shënohen deklaratat e çastit të bëra nga personi, nëse është i pranishëm, ndaj të cilit është bërë kontrolli. 5. Personit, të përmendur në pikën e mësipërme, i bëhet e ditur para fillimit të veprimeve, se mund të kërkojë mbrojtjen me avokat. 6. Oficeri i policisë gjyqësore i, dërgon prokurorit procesverbalin e mësipërm brenda dyzet e tetë orëve, i cili brenda dyzet e tetë orëve në vijim vlerëson kontrollin."

Gjykata në këtë rast gjen të pëmbushura kushtet e parashikuara në dispozitën e mësipërme. Nga ana e oficerit të policisë gjyqësore është konstatuar shkelja dhe është mbajtur edhe procesverbal i sekuestrimit të mjetit lundrues. Personi apo personat e interesuar në këtë rast janë larguar, duke braktisur mjetin lundrues, ndaj nuk ka deklarime të tyre në aktet. Po kështu, rezultoi që prokurorisë ti jenë dërguar aktet brenda 48 orëve, pra më datë 23.04.2013 dhe nga kjo e fundit të jetë vlerësuar i ligjshëm ky sekuestrim i sendit mjet lundrimi.

Neni 24 i ligjit të mësipërm parashikon si vepër penale atë të quajtur "Mungesa e matrikullimit ose e regjistrimit"

Sipas kësaj dispozite:

"1. Pronësia, mbajtja ose zotërimi i një mjeti lundrues, objekt i këtij ligji, të pamatrikulluar ose të

paregjstruar, sipas nenit 5, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 100.000 (njëqind mijë), deri në 200.000 (dyqind mijë) lekë, si dhe me konfiskimin e mjetit lundrues. 2. Oficeri ose agjenti i policisë kufitare, i cili ka verifikuar shkëlqen, sekuestron mjetin lundrues dhe respekton procedurën e parashikuar në paragrafët 3, 4, 5 e 6 të nenit 31. 3. Gjykata, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e masës së sekuestrimit, vendos për konfiskimin e mjetit lundrues."

Pra në këtë rast, nga data 21.04.2013 që është kryer sekuestrimi i mjetit lundrues të llojit gomone, me ngjyrë të bardhë, me mbishkrimin "EDDI" në të dyja krahët dhe mbishkrimin "MARES" në kabinën e pilotimit, si dhe një gjatësi 6 metër dhe gjerësi 2,2 metër, me dy motora të markës "Suzuki 150 hp" dhe "Parsun 9,9 hp" kanë kaluar më pak se 15 ditë, gjykata ndodhet brenda afatit brenda të cilit ajo ka të drejtën të vendosë për konfiskimin e këtij mjeti lundrues.

Për sa më sipër, gjykata e gjen të bazuar në ligj dhe në prova kërkesën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për konfiskimin e mjetit të mësipërm, ndaj e pranon atë.

#### PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar në nenin 23/3 dhe 24/3 të ligjit nr 8863 datë 18.09.2000 "Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor me tonazh nën 20 nt",

#### VENDOSI

1. Pranimin e kërkesës së kërkuesit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë.
2. Konfiskimin e mjetit lundrues të llojit gomone, me ngjyrë të bardhë, me mbishkrimin "EDDI" në të dyja krahët dhe mbishkrimin "MARES" në kabinën e pilotimit, si dhe një gjatësi 6 metër dhe gjerësi 2,2 metër, me dy motora të markës "Suzuki 150 hp" dhe "Parsun 9,9 hp" dhe kalimin e tij në favor të shtetit.
3. Mjeti i mësipërm i besohet në ruajtje Drejtorisë së Rezervave të Shtetit.

Shpallet në Vlorë, sot më datë 02.05.2013

SEKRETARE  
ENTELE OMERI

GJYQTARE  
VJOLA CANAJ

12 05 2013

20

Shpenzimet gjyqesore  
Shpenzime kancelerike 500 leke  
Gjithsej 500 leke

  
Sekretare/Entefa Omeri